



PRANUAR ME
ACCEPTED ON 15.08.2023
PRILJENO

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës
Nr.02/
Datë: 31.07.2023

15.08.2023		
-01- 020-654/L		

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2, pika d, nenit 14 paragrafi 1, të Ligjit Nr.03/040, për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 14, nenit 21 paragrafi 1 pika 1.3 dhe paragrafi 2, të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.10/03, prill 2019), nenit 25 paragrafi 1.1, 1.2 dhe neni 2, neni 25 par 3 të Rregullores (QRK) nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 5.2 të Ligjit nr.2003/11 për Rugët, ("Gazeta zyrtare Nr.16/01 Shtator 2007"), nenit 3 në lidhje me plotësimin dhe ndryshimin e nenit 5 paragrafi 5.2. të Ligjit Nr.03/L-120 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.46/15 Janar 2009") për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rugë Nr.2003/11, nenit 9 paragrafi 1,2 të Ligjit nr.05/L-081 për Energjinë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.24/13 Korrik 2016"), nenit 10 paragrafi 1 pika h, nenit 19 paragrafi 1 shkronja a, nenit 46 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, kërkesën e Kryetarit të Komunës nr.02/317 datë:22.06.2023,

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 31.07.2023 miraton këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE

1. Miratohet kërkesa nr.02/317 datë, 22.06.2023 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale KEDS-it, për vendosjen e stabilimenteve të nevojshme energjetike si dhe zhvendosja e stabilimenteve të vjetra në disa fshatra të Komunës së Malishevës, sipas kërkesës së parashtruar nga KEDS, të datës 21.06.2023, me numër të referencës nr.01/813, "projekti me planin Investive 2022, për regjionin e komunës së Malishevës".

2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi pronat që do të jepen në shfrytëzim të KEDS-it, për zgjerim dhe përforsim të rrjetit distributiv në disa fshatra do të jepen në *periudhën afatgjate prej 50 viteve, me kompensim prej 10 €, për m² qira vjetore*, për interes të përgjithshëm publik për realizimin investimeve në sektorin e energjisë përkatësisht vendosjen e stabilimenteve të nevojshme energjetike dhe zhvendosja e stabilimenteve të vjetra në disa fshatra si në vijim;

2.1. Projekti "Lubizhdë II-TS i ri " vendosja e trafo-stacionit të tipit shtyllë betoni 10(20)/0.4kV me fuqi 160 kVA, lejohet hapësira prej 9 m² në kuadër të parcelës nr.00728-0,ZK -Lubizhdë (pronë publike-KK-Malishevës).

2.2. Projekti " Shkoza 1 ", zhvendosja e trafo-stacionit ekzistues " Shkoza -1 "shtyllë metalike 10(20) 0.4kV, me fuqi 250 kVA, lejohet në hapësira prej 9 m² në kuadër të parcelës nr.002169-0,ZK Shkoze (pronë shoqërore-rrugët).

5. Pronat e paluajtshme në fjalë nuk e ndërrojnë titullarin juridik, pronësia i mbetet Kuvendi Komunal të Malishevës, dhe si të tilla ato nuk mund tu jepen personave të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohen, nuk mund të jenë objekt i ndonjë barre tatimore, bankare apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këto prona.

6. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronëso- Juridik që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të zbatoj të gjitha procedurat për përcaktimin e pikave përkufizuese të lokacioneve të caktuara dhe të evidentohet në librat kadastral të Komunës, ndërsa Drejtoria për Urbanizëm të përgatisë dokumentet e kërkuara urbanistike.

7. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kërkesa, skica grafike dhe certifikatat e njësisë kadastrale.

8. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronëso- Juridik.

9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet
MAPL-së,
Drejtoreve kompetente,
KEDS,
Arkivit të komunës.

